



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË SHËRBIMIT SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkuara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Regjistri i pasurive kapitale i prezantuar në PVF ishte mbivlerësuar për 1,016,094€, ndërsa regjistri i pasurive jo kapitale ishte mbivlerësuar për 880,244€ si pasojë e mangësive në mbajtjen e regjistrave të pasurive dhe prezantimin e tyre.
- B2 Si pasojë e gabimeve në konsolidimin e të dhënave të PVF-ve për vitin 2024, detyrimet kontingjente ishin nënvlerësuar për 933,522€, ndërsa obligimet ishin mbivlerësuar në vlerën 63,737€.
- A1 Kalkulim jo i duhur i shtesave të kujdestarive për ditën e premtë ka shkaktuar shpenzime financiare shtesë prej 137,368€ vetëm në QKUK.
- B3 Shpenzimet ishin keqklasifikuar në vlerë prej 124,633€ duke ndikuar në mbivlerësim/nënvlerësim të kategorive joadekuate.
- B4 Në Spitalin e Prizrenit pasuria "Kombi Bus - 4 dyer" figuronte në regjistrat e pasurisë, por nuk kemi arritur të konfirmohet ekzistenca e saj fizike.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Në tre raste në procedura të prokurimit, SHSKUK, kishte shpërblyer me kontratë operatorët ekonomik edhe pse nuk i kishin përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit vlera e përbashkët e tyre ishte 877,679€.
- B5 Në katër raste në vlerë 381,871€, kemi vërejtur që faturat e pranuar nuk ishin paguar brenda afatit të përcaktuar. Vonesat varionin nga 7 ditë deri në 60 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesues i Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm janë menaxhimi i pasurive me theks të veçantë regjistrimi i plotë dhe i saktë i pasurive kapitale dhe jo kapitale, klasifikimi adekuat i shpenzimeve si dhe prezantimi i drejtë i shpalosjeve në paqyra financiare.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus më i madh duhet t'i kushtohet shmangies së vonesave në ekzekutimin e pagesave si dhe evitimit të mangësive në fushën e prokurimit.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja dhe shtatë (7) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mbivlerësim i regjistrave të pasurive në PFV si pasojë e mangësive në regjistrimin dhe mbajtjen e tyre

Gjetja

Rregullorja Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.3, specifikon se "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Ndërsa me neni 22, përcaktohet metoda e zhvlerësimit të pasurive, norma e zhvlerësimit si dhe llogaritja bazuar në natyrën e pasurisë.

Ne kemi identifikuar disa mangësi sa i përket mbajtjes së regjistrave të pasurive të cilat kanë ndikuar në paraqitjen jo të saktë të vlerës së tyre në PFV. Si rezultat, vlera e pasurive kapitale e prezantuar në PVF ishte e mbivlerësuar për 1,016,094€ (ndikuar nga mbivlerësimi në vlerë prej 1,349,168€ dhe nënvlerësimi për 333,074€), ndërsa regjistri i pasurive jo kapitale ishte mbivlerësuar për 880,244€ (ndikuar nga mbivlerësimi për 1,005,905€ dhe nënvlerësimi për 125,661€) si pasojë e disa mangësive në mbajtjen e regjistrave të pasurive dhe konsolidimin e të dhënave në PFV.

Mangësitë e identifikuara sa i përket mbajtjes së regjistrave janë si në vijim:

- Pesë (5) pasuri (pajisje mjekësore) të blera në vitin 2012, me vlerë neto në libra 1,304,761€, ishin kategorizuar gabimisht në regjistrin e pasurive kapitale duke u zhvlerësuar për 40 vite. Si rezultat i aplikimit të normës jo të duhur të zhvlerësimit, vlera e pasurive financiare e prezantuar në PFV ishte e mbivlerësuar për të njejtën shumë.
- Regjistri i pasurive kapitale në SIMFK ishte mbivlerësuar në vlerë 44,407€ si rezultat i regjistrimit të dyfishtë të dy transaksioneve, në anën tjetër regjistri i pasurive jo kapitale ishte mbivlerësuar si rezultat

i regjistrimit të shumëfishtë të disa pasurive në e-pasuria në vlerë 370,849€, si dhe në katër pagesa në vlerë prej 230,791€ materiali shpenzues ishte regjistruar si pasuri jo kapitale.

- Po ashtu, si rezultat i mos regjistrimit të pasurisë kapitale për gjashtë (6) pagesa në vlerë të përbashkët prej 333,074€ regjistri i pasurive kapitale ishte nënvlerësuar për të njëjtën vlerë. Për më tepër, për shkak të mos regjistrimit të pasurive jo kapitale të shtatë (7) pagesave, vlera e pasurive në regjistër ishte e nënvlerësuar për 125,661€.

Më tej, pasuria jo kapitale e prezantuar në PFV ishte e mbivlerësuar për 404,265€ për shkak të mangësive në konsolidimin e të dhënave. Sipas dokumenteve burimore vlera e pasurive jo kapitale ishte 4,654,039€, kurse në PVF ishte prezantuar 5,058,304€. Gjithashtu, vlen të theksohet se, ndër të tjera, në vlerën e pasurive në PVF ishte përfshirë inventari i imët të Spitalit të Përgjithshëm në Pejë në vlerë 464,473€, si dhe mos përfshirja pasuria e Qendrës së Shëndetit Mendor në Ferizaj në vlerë 60,002€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme, si dhe për shkak se me rastin e blerjes së këtyre pasurive ndër vite, këto transaksione të blerjes së pasurive ishin keq kategorizuar në regjistrin e pasurive. Edhe pse kjo gjetje është trajtuar tashmë disa vite në raportet tona, SHSKUK nuk ka ndërmarrë veprime për t'i bërë përmirësimet në regjistra sa i përket këtyre pasurive.

Ndikimi

Mos regjistrimi i blerjeve, regjistrimi i shumëfishtë i pasurive dhe regjistrimi i materialit shpenzues si pasuri kanë ndikuar në prezantim jo të drejtë dhe të vërtetë të informatave në PVF.

Rekomandimi B1

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që pasuria kapitale të regjistrohet në vlerën e saktë, në mënyrë që raportimi i tyre në PFV të jetë i drejtë dhe i vërtetë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Pasaktësi në prezantimin e detyrimeve kontingjente dhe obligimeve në PVF

Gjetja

Rregullorja Nr. 01/2017 Për Raportimin Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore - Neni 6, përcakton se Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informacionet financiare dhe informacionet tjera jofinanciare. Sipas Nenit 18, Organizatat buxhetore, raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente. Ndërsa neni 17, pika 3, parasheh se organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri me 31 dhjetor të vitit raportues.

- SHSKUK për vitin 2024 kishte nënvlerësuar detyrimet kontingjente për 933,522€. Bazuar në dokumentet burimore, vlera e detyrimeve kontingjente ishte 6,919,072€, kurse në PVF ishin prezantuar 5,985,550€.
- Për më tepër, ShSKUK, në dokumentet e saj burimore, ka paraqitur se nga 4,062 detyrimet totale kontingjente, të cilat kryesisht janë të natyrës së njëjtë, 13% e tyre (ose 524 detyrime kontingjente) nuk kanë një vlerë financiare të përcaktuar.

- Për më tepër, në raportin e përgjithshëm të obligimeve në PFV-të janë prezantuar obligimet që nuk i takojnë vitit raportues (pasi ishin pranuar në vitin 2025) duke ndikuar kështu në mbivlerësim të obligimeve në vlerë prej 63,737€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i koordinimit jo të duhur gjatë konsolidimit të të dhënave nga programet përkatëse, me qëllim të prezantimit të PFV-ve të SHSKUK-së. Edhe përkundër rekomandimit të ekipit të auditimit gjatë rishikimit të PFV-ve, nuk është kryer verifikimi i nevojshëm i shënimeve në shpalosje për të siguruar që pasqyrat janë të plota dhe të sakta para finalizimit të tyre. Për më tepër, mungesa e një vlerësimi financiar të detyrimeve kontigjente në anekse mund të krijojë paqartësi të përdoruesit e pasqyrave financiare, të rrisë rrezikun e keqinterpretimit dhe të ndikojë në besueshmërinë e tyre.

Ndikimi	Kjo ka ndikuar në prezantimin jo të saktë të të dhënave në PFV duke ulur besueshmërinë dhe transparencën e informacionit financiar të paraqitur për palët e mundshme të interesit.
Rekomandimi B2	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë koordinimin më efektiv ndërmjet programeve dhe të vendosen mekanizma të duhur për konsolidimin e të dhënave financiare. Po ashtu, të kryhet verifikim i plotë dhe i detajuar i pasqyrave financiare përpara dorëzimit të tyre, me qëllim të sigurimit që të dhënat të jenë të sakta, të plota dhe në përputhje me kërkesat e raportimit financiar. Si dhe, të ndërmarrë masa për të përcaktuar një vlerë financiare të mundshme për detyrimet kontigjente, në mënyrë që të ofroj një pamje të qartë dhe të drejtë të gjendjes financiare të organizatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Kalkulim jo i duhur i shtesave të kujdestarive për ditën e premte

Gjetja	<p>Sipas Ligjit të punës nr.03/L-212, neni 56, paragrafi 2.1, si dhe Rregullores 07/2023 për kompenzimin për kujdestari punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, neni 4, paragrafi 2.1, të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë 20% në orë për kujdestari.</p> <p>Sipas të dhënave të siguruara, shtesat për kujdestarit e ditës së premte janë llogaritur me 150% të pagës bazë, si për kujdestaritë gjatë fundjavës. Si rezultat i këtij kalkulimi të gabuar, i cili ka sjellë një pagesë prej 30% më shumë se sa duhej, vetëm në QKUK është krijuar një shpenzim financiar shtesë prej 137,368€. Nga testimet e mostrave në Spitalet në Vushtrri dhe në Prizren, është vërejtur se është aplikuar praktikë e njejtë për kalkulimin e orëve të kujdestarisë së ditës së premte. Për shkak të mungesës së të dhënave të plota, nuk ka qenë e mundur të bëhet një vlerësim i saktë i efektit financiar të këtij kalkulimi në institucionet e tjera shëndetësore.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i mos harmonizimit të kalkulimit pas ndryshimeve të kornizës ligjore lidhur me kompenzimin e kujdestarive.</p>
---------------	---

Ndikimi	Llogaritja e shtesës për kujdestarin, e cila nuk është në përputhje me
----------------	--

legjislacionin në fuqi, ka rezultuar në një rritje prej 30% të shumës së caktuar, duke shkaktuar shpenzime financiare më të larta se sa planifikohen.

Rekomandimi A1 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se janë bërë analiza për vlerësimin e ndikimit të kësaj çështje edhe në programet tjera të ShSKUK-së, si dhe janë ndërmarrë masa që të sigurojnë që kalkulimi i shtesës për kujdestarin e ditës së premtë të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Rregulla financiare nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, neni 18 paragrafi 3 përcakton se shpenzimet duhet të realizohen dhe të evidentohen në kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, Udhëzimi Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël, neni 11, kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë udhëzim. Ndërsa plani kontabël Dhjetor 2023 specifikon saktësisht regjistrimin e shpenzimeve në të gjitha kodet ekonomike.

Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë kryer pagesa dhe regjistruar shpenzime në vlerë total prej 124,633€ të cilat sipas natyrës nuk i takojnë kësaj kategorie, si në vijim:

- Në Spitalin e Përgjithshëm në Mitrovicë, dy pagesa në vlerë 99,168€ ishin ekzekutuar jo drejtë në kategorinë e mallra dhe shërbimeve të cilat për nga natyra i takonin kategorisë së investimeve kapitale. Këto pagesa kishin të bënin me projektim dhe renovim të reparteve së bashku me salla operative dhe renovim të reparteve spitalore.
- Po ashtu, për shkak të ekzekutimit të pagesave nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore, në QKUK, nga kategoria e mallra dhe shërbimeve ishin ekzekutuar shpenzime në vlerë prej 33,291€. Borxhi kryesor kishte ndikuar në keqklasifikimin e shpenzimeve në vlerë prej 25,465€ pasi për nga natyra i takonte kategorisë së paga dhe mëditjeve sepse kishin të bënin me pagesat e dala nga marrëveshja kolektive për pagesë të pagave jubilarë.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së një analize të natyrës së shpenzimeve nga ana e zyrtarit autorizues gjatë planifikimeve buxhetore.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoria jo adekuate e shpenzimeve ndikojnë në mbivlerësim/nënvlerësim të kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe rrjedhimisht në paraqitje jo të saktë dhe të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B3 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë marrë masat e duhura që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet përkatëse ekonomike sipas planit kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ShSKUK-së, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mungesa e pasurisë

Gjetja Sipas nenit 8 të Rregullores MF - NR. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare - Pranimi i pasurisë jo financiare bëhet nga blerja, ndërtimi, dhurimet dhe transferet nga organizatat tjera buxhetore.

Për pasurinë "Kombi Bus - 4 dyer" në vlerë origjinale prej 25,000€, e cila sipas regjistrimit i përket Spitalit të Prizrenit, nuk ishin siguruar evidenca që do të dëshmonin ekzistencën e saj dhe se është në përdorim, apo se pasuria është tjetërsuar apo dhuruar. Për të njëjtën ishte raportuar edhe në raportin e viti paraprak, mirëpo gjendja vazhdon të jetë e njëjtë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së politikave të qarta për regjistrimin, verifikimin dhe mbajtjen e pasurisë. Po ashtu, mungesës së përgjegjësisë nga ana e zyrtarëve përgjegjës të Spitalit të Prizrenit për ofrimin e informatave të pasurisë që mbajnë në regjistra dhe identifikimin fizik të saj.

Ndikimi Pa mundësia për të dëshmuar ekzistencën fizike të pasurisë të cilën e mban në regjistra, në mungesë të informatave për të njëjtën, rritë mundësinë e keqpërdorimit të pasurisë, humbjes apo tjetërsimit.

Rekomandimi B4 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë ashtu që të sigurojnë informata dhe dëshmi për ekzistencën fizike për të gjitha pasuritë e mbajtura në regjistra, në mënyrë që të evitohet mundësia e humbjes apo keqpërdorimit të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Shpërblimi me kontratë i Operatorëve Ekonomik të papërgjegjshëm

Gjetja

Sipas Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës (LPP), në nenin 28, kërkesat teknike për ofertuesit duhet të jenë të qarta dhe të sakta për të siguruar një konkurrencë të barabartë dhe të drejtë. Neni 59, pika 4, përcakton që një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse përputhet me kërkesat e njoftimit të kontratës dhe dosjes së tenderit. Gjithashtu, nenet 69 dhe 70 kërkojnë që ofertuesit të paraqesin dokumentacion të vërtetuar për licencat dhe certifikatat që vërtetojnë aftësitë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës. Nga ana tjetër, sipas Rregullores nr. 001/2022, neni 25, pika 25.7, Operatorët Ekonomik janë të obliguar të paraqesin dokumente që vërtetojnë përshtatshmërinë profesionale sipas nenit 66 të LPP-së, si dhe një kopje të certifikatës të konfirmuar nga organi kompetent përkatës.

Udhëzimi Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik thekson që çdo kërkesë për mbështetje nga prodhuesi dhe furnizuesi duhet të jetë e dokumentuar, duke siguruar që mbështetja për pajisjet të jetë e sigurt dhe e disponueshme. Sipas Udhëzimit Administrativ MASHT nr. 12-2018, çdo qytetar që ka marrë diplomën jashtë Kosovës është i obliguar të kërkojë njohjen e saj për punësim në Republikën e Kosovës.

Për procedurën e prokurimit “Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore” me vlerë të kontratës 231,500 €, QKUK shpërbleu me kontratë OE edhe pse nuk i kishte përmbushur të gjitha kërkesat e kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Kushtet teknike në këtë tender kërkojnë që serviseri të ketë licencë nga prodhuesi për të mbuluar të gjitha markat e pajisjeve të kërkuara, përfshirë markat: Samsung, Bayer Medrad, Artronic, dhe UPS 120Kva Galaxy 5500. Megjithatë, OE ka ofruar vetëm licencën për servisimin e markës Philips, dhe jo për markat e tjera. Përveç kësaj, dosjes së tij i mungon deklarata nga prodhuesi që garanton mbështetje për kompaninë ofertuese, përfshirë furnizimin me pjesë rezervë, si dhe asistencë për çështje softuerike, përditësime dhe përmirësime të mundshme të programeve për pajisjet në fjalë.

Për procedurën e prokurimit “Renovimi i ambulantave të pranimit në Klinikën ORL dhe Oftamologji” me vlerë të kontratës 346,346 €, QKUK shpërbleu me kontratë OE, edhe pse nuk i kishte përmbushur të gjitha kërkesat e kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. OE ka paraqitur në ofertë certifikatat për ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, dhe ISO 45001:2018, por këto certifikata janë të skaduara më 10.03.2024, ndërkohë që njoftimi për kontratë është bërë më 05.04.2024, duke i bërë ato të pavlefshme. Për më tepër, mungojnë dokumentet e kërkuara për stafin teknik, përfshirë diplomën e shkollës së mesme të noterizuar për pozitat përkatëse.

Për procedurën “Ndërtimi i depos Sanitare Farmaceutike” me vlerë të kontratës 299,833 €, Spitali i Përgjithshëm Pejë, operatori fitues në ofertën e tij për pozitat e inxhinierit hidroteknik, ka paraqitur një diplomë baçelor, por kjo diplomë nuk është noterizuar, ndërsa diploma e nivelit master është e noterizuar, por ajo duhet të nostrifikohet pasi është fituar në Shqipëri. Për

pozitën e inxhinierit të ndërtimtarisë/konstruktiv, certifikata për auditimin e energjisë në ndërtesa që është paraqitur nuk përputhet me certifikatën e kërkuar, përkatësisht certifikatën për auditor të eficiencës. Po ashtu, në FTD, përkatësisht në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, është kërkuar që, nëse ka marrëveshje për qira të pajisjeve, ajo të mos jetë lidhur para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Megjithatë, OE ka lidhur marrëveshje për pajisjen për matjen e sasisë së betonit me datën 20.06.2024, pas datës së kërkuar më 29.05.2024.

Shkak i këtyre veprimeve ishte pakujdesia e anëtarëve të komisionit të cilët i vlerësuan si të përgjegjshme ofertat e OE, edhe përkundër faktit që ofertat nuk i përmbushnin të gjitha kushtet sipas Ligjit të Prokurimit Publik dhe akteve tjera juridike në fuqi. Po ashtu, përcaktimi jo i duhur i specifikave kishte ndodhur si rezultat i mungesës së njohurive nga njësia kërkuuese gjatë hartimit të specifikave dhe mungesës së kontrolleve nga zyrtarët e prokurimit për të parandaluar këtë devijim.

Ndikimi Mosrespektimi i legjislacionit në fuqi mund të rrezikoj cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve, si dhe mungesën e transparencës dhe barazisë në proces. Këto mangësi mund të çojnë në pasoja ligjore, vonesa, shpenzime shtesë dhe humbjen e besimit nga OE dhe palët tjera, duke dëmtuar integritetin dhe efikasitetin e sistemit të prokurimit publik.

Rekomandimi A2 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojnë kontrollet e brendshme dhe përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit të sigurohen se anëtarët e komisioneve vlerësuese konsiderojnë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Po ashtu, të sigurohen kontrolle efektive tek njësitet kërkuuese dhe në zyrën e prokurimit me qëllim që të evitohet përdorimi i kriterëve të paqarta me rastin e hartimit të specifikave teknike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B5 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja LMFPP, neni 39.1 përcakton që: ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet të furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në katër (4) raste në vlerë 381,871€, kemi vërejtur që faturat e pranuar nuk ishin paguar brenda afatit të përcaktuar. Vonesat varionin nga 7 ditë deri në 60 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Vonesat kane rrjedhur si rezultat i mungesës së mjeteve financiare dhe funksionim jo të duhur të sistemit të kontrolleve për kryerjen e obligimeve sipas afateve të përcaktuara.

Ndikimi Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund ta bëjë SHSKUK-në

subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbare apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi B5 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda 30 ditëve pas pranimi të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 251,473,730€, pasurive jokapitale 5,058,304€, si dhe e stoqeve 12,854,660€.

Çështja B6 - Mos-harmonizimi i regjistrave të inventarizimit me regjistrat e pasurive

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, neni 19, Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i organizatës buxhetore. Përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare ndër të tjera janë: inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të organizatës buxhetore; verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare; dhe krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Në Spitalin e Gjilanit ishte formuar komisioni për inventarizim të pasurisë, mirëpo i njëjti nuk e kishte kryer inventarizimin e pasurisë sipas kërkesave të rregullores. Referuar raportit të komisionit ky proces nuk është kryer pasi që kishte hasur në pengesa. Kjo ka pamundësuar harmonizimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive. Në anën tjetër, harmonizimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave ishte i pamundur në Spitalin e Prizrenit, si dhe në Telemjekësi pasi që inventarizimi ishte bërë pas përgatitjes së PVF-ve.

Gjatë këtij auditimi të SHSKUK, janë identifikuar disa mangësi lidhur me menaxhimin e pasurive, përfshirë mungesën e pasurisë, regjistrime të shumëfishta dhe gabime në regjistrim. Këto mangësi pasqyrojnë mungesën e një procesi të duhur të inventarizimit dhe harmonizimit me regjistrat përkatës, i cili do të mundësonte identifikimin e problemeve para se ato të ndikonin në pasqyrat financiare.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të neglizhencës dhe mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive.

Ndikimi Mos kryerja e inventarizimit sipas kërkesave të rregullores përkatëse mund të ndikojë në mos raportimin e saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive në PFV.

Rekomandimi B6 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se sistemi i vendosur i kontrollit është mjaftueshëm efikas dhe siguron se po kryhet procesi i inventarizimit periodik të pasurisë sipas kërkesave të rregullores në fuqi në mënyrë që të kemi një raportim të saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Funksionalizimi jo i plotë i sistemit e-pasuria**Gjetja**

Sipas Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare - neni 6.3 parasheh se Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Edhe përkundër rekomandimeve të dhëna ndër vite, SHSKUK, as gjatë vitit 2024 nuk kishte arritur funksionalizimin e sistemit e-pasuria në të gjitha programet e saja:

- QKUK kishte bërë regjistrimin e pasurisë në sistemin e-pasuria vetëm për pasuritë e blera në vitin 2024, por jo edhe për pasuritë e blera në vitet paraprake dhe si rezultat pasuria e viteve paraprake nuk është prezantuar fare në PVF;
- Spitalet e Përgjithshme në Vushtrri, Mitrovicë, Pejë dhe Prizren nuk e kishin funksionalizuar sistemin e-pasuria, mirëpo regjistrimin e kishin bërë në regjistra të brendshme Excel;
- Spitali i Përgjithshëm Gjilan nuk kishte bërë regjistrimin e pasurive në sistemi e-pasuria për shkak të mungesës së zyrtarit të pasurisë;
- Qendrat e Shëndetit Mendor në Prishtinë, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan nuk e kishin funksionalizuar sistemin e-pasuria dhe si pasojë prezantimi i pasurisë në PVF është bërë në bazë të numërimit fizik të pasurisë.

Mos funksionalizimi i plotë i sistemit e-pasuria, ishte rezultat i përpjekjeve jo të mjaftueshme dhe mungesës së veprimeve të nevojshme dhe në kohë nga ana e SHSKUK-së.

Ndikimi

Mos përdorimi i sistemit e-pasuria rrit mundësinë e gabimeve në mirëmbajtjen e regjistrave, shlyerjeve potenciale, keqpërdorimit, humbjes apo të tjetërsimit tyre.

Rekomandimi B7

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrin të gjitha veprimet e nevojshme për funksionalizimin e plotë të sistemit të e-pasurisë dhe i njëjti të jetë bazë për raportimin e pasurisë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate rishikimit të PFV-ve u identifikuan disa gabime që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Kjo çështje nuk kërkon ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohet vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre.

Çështja materiale e identifikuar dhe e përmirësuar gjatë kohës së auditimit është paraqitur si më poshtë:

Çështja 1	Paraqitje jo e saktë e pranimeve dhe shpalosjes së pasurive jo kapitale në PFV
Gjetja	<p>Në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të SHSKUK-së për vitin 2024, tek Neni 13 Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, burimi i fondeve, është prezantuar vlera 3,501,000€ si pranime nga të hyrat vetanake, në vend se të ishin prezantuar 170,349,000€ si pranime nga granti qeveritar dhe 111,000€ nga grantet e përcaktuara të donatorëve. Rrjedhimisht, kishte një nënvlerësim në total në vlerë prej 166,959,000€.</p> <p>Në anën tjetër, tek Neni 19.3.2 pasuria jo kapitale është prezantuar në vlerë prej 130,661,650€, në vend se të ishte prezantuar 5,058,304€. Kjo kishte ndikuar në mbivlerësimin e këtyre regjistrave në vlerë prej 125,603,346€.</p>
Veprimi i kërkuar	Rishikimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) për vitin 2024 i kryer nga ekipi i auditimit ka vënë në pah nevojën për korrigjin e tyre me qëllim të prezantimi të drejtë të vlerave financiare dhe ndikimit material të tyre.
Rezultati	Kjo çështje është korrigjuar nga entiteti pas konsultimeve me ekipin e auditimit brenda afateve ligjore të përcaktuara nga Thesari.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	174,387,768	173,821,273	170,460,810	154,716,693	129,066,604
Grante Qeveritare - Buxheti	174,387,768	173,706,785	170,348,877	148,110,128	123,580,480
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	6,605,585	5,465,547
Donacionet vendore	0	113	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	114,374	111,933	980	20,577

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 566,495 €. Kjo ulje është rezultat i shkurtimeve buxhetore.


Në vitin 2024 SHSKUK ka shpenzuar 98% të buxhetit përfundimtar ose 170,460,810€, me një realizim të përafërt në krahasim me vitin 2023.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	174,387,768	173,821,273	170,460,810	154,716,693	129,066,604
Pagat dhe mëditjet	86,902,161	89,975,178	89,971,846	84,532,481	70,231,105
Mallrat dhe shërbimet	64,547,091	66,257,530	63,711,039	58,769,656	49,576,205
Komunalitë	3,639,016	3,639,016	3,626,047	4,175,220	3,542,744
Investimet Kapitale	19,299,500	13,949,548	13,151,879	7,239,337	5,716,550

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,073,018€, rritje kjo si rezultat i ndryshimit të ligjit të pagave për zyrtar publik . Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,710,439€. Realizimi i kësaj kategorie ishte 96%.
- Buxheti final për komunal, në raport me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Realizimi i kësaj kategorie ishte 96%.
- Buxheti final për investime kapitale, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 5,349,952€, si rezultat i shkurtimeve buxhetore në fund të vitit. Nga 26 projektet e planifikuara, 11 nga këto nuk kanë realizuar asnjë shpenzim, dhe se kjo kishte ndikuar në shkurtime buxhetore. Për tetë nga 11 projektet e porealizuara nuk ishte iniciuar asnjë kërkesë për prokurimin e këtyre projekteve. Realizimi i kësaj kategorie ishte 94%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga SHSKUK për vitin 2024 ishin më të ulëta se të hyrat e planifikuara për 306,811€. Ato kanë të bëjnë me të hyra nga participimet, të hyrat nga taksa për parkim publik, të hyrat nga taksa si certifikatë mjekësore, etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	3,808,863	3,808,863	3,502,065	3,759,915	3,230,451
Të hyrat jo tatimore	3,808,863	3,808,863	3,501,459	3,759,915	3,230,451
Të hyrat tjera	0	0	606		

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të SHSKUK ka rezultuar në 11 rekomandime. SHSKUK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, katër (4) rekomandime janë zbatuar dhe shtatë (7) rekomandime nuk ka filluar zbatimin, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Krahasuar me vitin e kaluar gjendja e implementimit të rekomandimeve mbetet e njëjtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojnë kontrollet në menaxhimin e pasurisë ashtu që të sigurojnë informata dhe dëshmi për ekzistencën fizike për të gjitha pasuritë e mbajtura në regjistra, në mënyrë që të evitohet mundësia e humbjes apo keqpërdorimit të pasurisë.	SHSKUK edhe gjatë vitit 2024 në mungesë të informatave e kishte të pamundur për të dëshmuar ekzistencën fizike të pasurisë të cilën e mban në regjistra	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për konkluzion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se, për kontratat që dihet afati i përfundimit, të fillojnë me kohë procedurat e prokurimit, duke i pasur në konsideratë edhe kohën që mund të marrin ankesat e OE-ve apo pengesat tjera potenciale, në mënyrë që të shmangin lidhjen e kontratave të kësaj forme që janë në kundërshtim me rregullat e prokurimit.	Nuk janë hasur raste të tilla gjatë auditimit të vitit aktual.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë kontrolle efektive tek njësitë kërkuese dhe në zyrën e prokurimit me qëllim që të evitohet përdorimi i kriterëve favorizuese me rastin e hartimit të specifikave teknike.	Nuk janë hasur raste të tilla gjatë auditimit të vitit aktual.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojnë kontrollet e brendshme dhe të sigurohen se para ekzekutimit të çdo pagese janë pranuar pajisjet sipas kontratës, me qëllim që të arrihet qëllimi për të cilin është shpenzuar paraja publike.	Nuk janë hasur raste të tilla gjatë auditimit të vitit aktual.	I zbatuar
5.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë kontrolle më të forta në përgatitjen dhe konsolidimin e të dhënave në PFV, në mënyrë që ato të prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë.	Gjatë analizimit të PVF-ve kemi vërejtur se edhe këtë vit PFV nuk ishin të sakta për faktin se detyrimet kontingjente, pasuria dhe obligimet e papaguara nuk ishin raportuar drejtë.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se me rastin e planifikimit të projekteve, bëhet një analizë e mirëfilltë e natyrës së shpenzimeve në mënyrë që projektet të buxhetohen në përputhje me natyrën e shpenzimit.	SHSKUK edhe gjatë vitit 2024 kishte raste të keqklasifikimit të shpenzimeve	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë përmes njësiteve kërkuese dhe departamentit të prokurimit, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luajnë një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale të spitalit, në mënyrë që këto kontratat të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshat e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Nuk janë hasur raste të tilla gjatë auditimit të vitit aktual.	I zbatuar

8.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë që pasuria kapitale të regjistrohet në vlerën e saktë, në mënyrë që raportimi i tyre në PFV të jetë i drejtë dhe i vërtetë.	Gjatë testimit kemi vërejtur se edhe gjatë vitit 2024 ka mbivlerësim të pasurive në regjistra.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se kryhet procesi i inventarizimit të pasurisë sipas kërkesave të rregullores në fuqi në mënyrë që të kemi një raportim të saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive në PFV.	Në disa programe SHSKUK edhe gjatë vitit 2024 nuk ishte bërë harmonizimin e gjendjes së pasurisë me regjistrat e pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrin të gjitha veprimet e nevojshme për funksionalizimin e plotë të sistemit të e-pasurisë dhe i njëjti të jetë bazë për raportimin e pasurisë në PFV.	SHSKUK edhe gjatë vitit 2024 nuk kishte funksionalizuar sistemi e-pasuria.	Nuk ka filluar zbatimi
11.	Obligimet e papaguara	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.	Edhe gjatë vitit 2024 ka pasur raste ku faturat e pranuar nuk ishin paguar me kohë.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit




Burbuqe Idrizi Ukaj, Udhëheqëse e ekipit



Drilon Osmani, Anëtar i ekipit



Fatbardha Jashari, Anëtare e ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Shpërblimi me kontratë i Operatorëve Ekonomik të papërgjegjshëm	<p>Koment nga Spitali i pejes: Përgjigje për gjetjen e auditorit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i depos Sanitare Farmaceutike” me vlerë 299,833 €:</p> <p>Autoriteti kontraktues ka vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore të përcaktuara në LPP dhe Rregulloren nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Procesi i inicimit dhe shpalljes së kontratës është bërë në sistemin e prokurimit elektronik me datë 10.06.2025, në përputhje me kërkesat për inicim dhe njoftim të kontratës.</p> <p>Lidhur me çështjen e diplomave, në dosjen e tenderit është paraparë kërkesa për staf profesional të diplomuar dhe me përvojë të dokumentuar, ku është paraparë si e vlefshme diploma e noterizuar apo e lëshuar nga institucione të njohura në Shqipëri. Në këtë rast, është pranuar një diplomë master e lëshuar në Shqipëri, e noterizuar, dhe e njëjta është në përputhje me kërkesat e dosjes dhe njoftimit për kontratë. Sa i përket nostrifikimit, vërehet se kërkesa për nostrifikim nuk ka qenë pjesë e dosjes së tenderit dhe nuk mund të kërkohej jashtë kërkesave të shpallura zyrtarisht.</p> <p>Sa i përket certifikatës për auditim të energjisë, është dorëzuar certifikatë e vlefshme e lëshuar nga institucion i licencuar sipas legjislacionit të MIE</p>	<p>E gjetura mbetet e pandryshuar, pasi që komentet e SHSKUK-së lidhur me çështjet e evidentuara nuk janë të mbështetura me dëshmi bindëse për të kundërshtuar këtë gjetje. Mangësitë në dokumentacionin e ofertës, mospërputhjet me kërkesat teknike dhe ligjore, si dhe mungesa e dëshmive përkatëse të kërkuara përbëjnë mospërputhje me kushtet e përcaktuara në shpallje si dhe legjislacionit në fuqi.</p>

dhe në përputhje me Ligjin për Efiçencën e Energjisë, Ligjin Nr. 06/L-079 dhe Ligjin Nr. 05/L-101 për performancën energjetike, prandaj është cilësuar si dokument i pranueshëm.

Në lidhje me qiradhënien e pajisjes për matjen e betonit - dokumenti i marrëveshjes për qira është nënshkruar me datë 20.06.2024, ndërkohë që shpallja për kontratë është bërë në sistem me datë 10.06.2025. Ky afat e plotëson kërkesën për njoftim dhe nuk paraqet shkelje, pasi kontrata për qiranë ishte e finalizuar para dorëzimit të ofertës dhe në përputhje me afatet e LPP.

QKUK lidhur me gjetjen e ZKA për procedurën e prokurimit "Renovimi i ambulanteve të pranimi në Klinikën ORL dhe Oftamologji" me vlerë të kontratës 346,346 € nuk pajtohem me këtë Gjetje.

Spjegim: Lidhur me certifikatat për ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, dhe ISO 45001:2018, të cilat I ka paraqitur ZKA si të skaduara, në ofertën e OE shihen qarte se data e ri certifikimit 11.02.2026, Intutucioni që ka lëshuar këto qertifikat nuk lshon ndonjë certifikat të re para skadimit të kësaj date 11.02.2026. Nga kontakti me organizatën kompetent e cila lëshon këto certifikata, kemi marrë konfirmimin se këto certifikata kanë qenë me validitet sipas dokumentit të prezantuar (të bashkengjitura certifikatat e ri-validuara). Në bazë të kësaj komisioni vlersues I ka marrë valide.

OE I ka ofruar të gjithë dokumentacionin e kërkuar për stafin ndihmës sipas kriterëve në Dosje të Tenderit dhe të notarizuara ku kriteri specifikon qart Diplom apo qertifikat Trajnimi (sipas kriterit në dosje të tenderit diploma e shkollës së mesme apo qertifikata e trajnimit është e barzëvlefshme.

Në draftin e raportit të auditimit të procedurës të prokurimit për mirëmbajtjen e pajisjes MRI-

(Rezonancës Magnetike), u theksua mungesa e certifikatave të teknikëve të servisit dhe deklaratave nga prodhuesit e kondicionerit të dhomës teknike, injektorit dhe UPS-it, lidhur me mbështetjen për pjesë këmbimi apo për përditësime të mundshme.

Dëshirojmë të sqarojmë se qëllimi kryesor i këtij Aktiviteti të Prokurimit ka qenë servisi dhe mirëmbajtja e pajisjes MRI (Rezonancës Magnetike) -(Philips), me synimin për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve diagnostike brenda institucioneve publike, dhe për të shmangur referimin e pacientëve jashtë sistemit publik, gjë që do të përbënte një barrë financiare të konsiderueshme për ta.

Për këtë qëllim është kërkuar nga ofertuesit që të ofrojnë si dëshmi Certificate të Serviserit të lëshuar nga prodhuesi i MRI-së (Philips), si dhe deklarate nga prodhuesi i MRI-së (Philips) që do ta mbështete me pjesë rezerve ofertuesin, si dhe me mbështetje në rast të problemeve softuerike dhe me update dhe upgrade të programeve .

Sistemet ndihmëse në këtë Aktivitet të Prokurimit siç janë: kondicioneri i dhomës teknike, injektori dhe UPS-i janë pajisje mbështetëse që sigurojnë kushte operative për MRI-në, por nuk përbëjnë pjesë përbërëse të pajisjes kryesore. Pajisjet ndihmëse të cekura nga Auditori siç janë: kondicioneri (Samsung) në dhomën teknike, injektori (Medrad) dhe UPS-i (Artronic), nuk janë pjesë integrale e MRI-së, por sisteme mbështetëse të ambientit dhe furnizimit me energji. Këto pajisje nuk posedojnë sistem për përditësime softuerike ose përmirësime teknologjike (update & upgrades), prandaj kërkesa për deklarata nga prodhuesi për mbështetje të ofertuesit nuk është vendosur për këto pajisje ndihmëse, por vetëm për pajisjen kryesore të përfshirë në këtë aktivitet të prokurimit- MRI-së (Rezonancës

| Magnetike) te prodhuesit Philips. |

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE-NATIONAL AUDIT OFFICE			
CITE-PRANUAR KONRZUAR			
KODI/ORGANIZACIONALNOJENI			
DATE-RECEIVED/REGISTERED			
Nr. Doku. Org. Jedin. Cpt. Unit	Sh. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
05	47	1043	60



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVO		SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIKA UNIVERSITARE I KOSOVËS	
THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO		ARHIVI QENDRORE - CENTRAL ARCHIVE	
Nr. i njehsis org. and org. unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. no.	2289	
Nr. i fol. No. page	Data Datum Date	18.06.25	
MHSIBINE PRISTINA - PRISTINA			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Bolnička i Klinička Univerzitetaska Sluzba Kosova (BKUSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Data, 18.06.2025

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; komentet gjinden në dokumentin përmbledhës për çdo gjetje një nga një si dhe dosja e deshmie.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Dren Boshnjaku, Kryesues i Bordit Drejtues në SHSKUK

z. Elvir Azizi, Drejtor i Përgjithshëm në SHSKUK

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Pasuria e cila ishte kategorizuar jo drejtë është · MOBILE X-RAY ADULT/PEDIATRIC WITH ACCESSORIES-
RADIOLOGJI; · CT/e Kompjuterizuar/Somatom/; · Rezonance
magn-MR Symphony; · RTG dig-AXIOM Aris.VXkomp; · RTG
dig-Axito Aris.VX kom; · CT Emotion 6 shtresor Simens
- ⁶ Dokumentet e kërkuara për stafin teknik për diplomën e shkollës së mesme të noterizuar ka të bëjë për pozitat përkatëse si :Monter i dyerve, qeramik-të dy punëtorët, latues, arminues, zdrukthëtar, elektrikist, saldues-të dy punëtorët, skelist-të dy punëtorët, moler, instalues i ujësjellësit dhe certifikimin përkatës për elektrikistët).
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.